



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 731, datë 07.12.2023

**PËR
KOMANDIMIN E Z. {...}
NË POZICIONIN KËSHILLTAR JURIDIK NË GJYKATËN EVROPIANE TË TË
DREJTAVE TË NJERIUT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi kërkesën e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, dërguar me Shkresën nr. 16271 prot., datë 30.10.2023, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Komandimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin e “këshilltar juridik”, në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për një afat deri më 31.12.2024.
2. Komandimi ndërpritet në rastin e verifikimit të ndonjë prej kushteve ndaluese të komandimit, sipas ligjit.
3. Gjatë kohës së komandimit në pozicionin e këshilltarit juridik, gjyqtari do të përfitojë pagën, si dhe do t’i paguhen kontributet e detyrueshme mbi të për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe për pension suplementar.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të komanduar z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
5. Ngarkohet Gjykata e Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për zbatimin e pikës 3 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR